



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
/ MINISTARSTVO ZDRAVSTVA / MINISTRY OF HEALTH

Udhëzim Administrativ Nr. 10 /2015 Mbledhja e Premiumeve për Sigurimin Shëndetësor të Obligueshëm

Administrative Instruction No. 10 /2015 Collection of Premiums for Mandatory Health Insurance

Administrativno uputstvo br. 10 /2015 Sakupljanje premija za obavezno zdravstveno osiguranje

<p>Ministri i Shëndetësisë,</p> <p>Në mbështetje të Nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit për sigurimin shëndetësor, Nr. 04 L-249, (Gazeta Zyrtare Nr. 29/30 prill 2014), nenit 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011), nxjerr:</p> <p style="text-align: center;">Udhëzim Administrativ Nr. XX /2015 Mbledhja e Premiumeve për Sigurimin Shëndetësor të Obligueshëm</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet dhe procedurat për pagesat dhe mbledhjen e premiumeve të sigurimit shëndetësor të obligueshëm, si dhe të drejtat dhe obligimet e subjekteve të përfshira.</p>	<p>Minister of Health,</p> <p>Pursuant to Article 12 Paragraph 1 of the Law on Health Insurance, No.04 L-249, (Official Gazette No. 29/30 April 2014), Article 8, subparagraph 1.4 of Regulation No. 02/2011 on the areas of administrative responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries as well as Article 38 paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government No. 09/2011 (Official Gazette No.15, 12.09.2011), issues:</p> <p style="text-align: center;">Administrative Instruction No. XX /2015 Collection of Premiums for Mandatory Health Insurance</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>With this Administrative Instruction are defined the conditions and procedures for the payment and collection of premiums for mandatory health insurance, and the rights and obligations of entities involved.</p>	<p>Ministar zdravstva,</p> <p>U skladu sa članom 12. stav 1 Zakona o zdravstvenom osiguranju br. 04 L-249 (Službeni list br. 29/30 aprila 2014), članom 8. pod-stav 1.4 Uredbe br. 02/2011 o oblastima administrativnih odgovornosti Kancelarije premijera i ministara, kao i članom 38. stav 6 Poslovnika o radu Vlade br. 09/2011 (Službeni list br. 15, 12.09.2011), donosi:</p> <p style="text-align: center;">Administrativno uputstvo br. XX /2015 Sakupljanje premija za obavezno zdravstveno osiguranje</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Ovim Administrativnim uputstvom se definišu uslovi i postupci za plaćanje i sakupljanje premija za obavezno zdravstveno osiguranje, kao i prava i obaveze subjekata koji su uključeni.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fusha e zbatimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope of implementation</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug primene</p>
<p>Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për të gjithë personat fizik dhe juridik, përfshirë punëdhënësit në sektorin publik, privat, publiko-privat dhe të vetëpunësuarit, përgjegjës për të paguar premiumet për sigurimin e obligueshëm shëndetësor, dhe institucionet e përcaktuara me ligj për mbledhjen e këtyre premieeve.</p>	<p>This Administrative Instruction applies to all natural and legal persons, including employers in the public, private, public-private sector and self-employed, responsible for paying premiums for mandatory health insurance, and institutions established by law for the collection of these premiums.</p>	<p>Ovo Administrativno uputstvo se primenjuje za sva fizička i pravna lica, uključujući poslodavce u javnom i privatnom sektoru, javno-privatnom i samozaposlene, koji su odgovorni za plaćanje premija za obavezno zdravstveno osiguranje, i institucije određene zakonom o sakupljanju ovih premija.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p>
<p>1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Qytetar - personi me shtetësi të Republikës së Kosovës sipas Ligjit mbi Shtetësinë e Kosovës, dhe personin e kualifikuar si refugjat në pajtim me ligjin;</p> <p>1.2. Banor - bartësi i lejes së qëndrimit të lëshuar nga autoriteti kompetent për territorin e Republikës së Kosovës dhe personin që ka aplikuar për njohjen e statusit të refugjatit;</p> <p>1.3. Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (në tekstin e mëtejme Fondi) – nënkupton institucionin publik të sigurimit shëndetësor me statusin e personit</p>	<p>1. Definitions used in this Administrative Instruction shall have the following meaning:</p> <p>1.1. Citizen - person with citizenship of the Republic of Kosovo according to the Law on Citizenship of Kosovo and person qualified as a refugee in compliance with the law;</p> <p>1.2. Resident - a bearer of a stay permit issued by the competent authority for the territory of the Republic of Kosovo and the person who applied for recognition of a refugee status;</p> <p>1.3. Health Insurance Fund (hereinafter referred to as the Fund) - a public health insurance institution, in capacity of a legal</p>	<p>1. Izrazi koji se koriste u ovom Administrativnom uputstvu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. Građanin – lica sa državljanstvom Republike Kosovo saglasno sa Zakonom o državljanstvu Kosova i lica koje je kvalifikovano kao izbeglica u saglasnosti sa zakonom;</p> <p>1.2. Stanovnik - nosilac dozvole boravka koju izdaje nadležni organ za teritoriju Republike Kosova i lica koje je podnelo zahtev za priznavanje statusa izbeglice;</p> <p>1.3. Fond zdravstvenog osiguranja - (u daljem tekstu Fond) podrazumeva javnu ustanovu zdravstvenog osiguranja koja ima status pravnog lica sa pravima,</p>

<p>juridik me të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të veçanta për zbatim të Ligjit për sigurime shëndetësore në emër të siguruarve përfshirë mbledhjen efektive të mjeteve financiare për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë;</p> <p>1.4. I siguruari - personi i cili mund të dëshmojë që është i përfshirë me sigurim shëndetësor;</p> <p>1.5. Anëtarë të familjes së ngushtë - konsiderohen: bashkëshorti/ja, prindërit, fëmijët deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare përfshirë fëmijët e adoptuar, thjeshtri/a, njerku/a;</p> <p>1.6. I punësuar – personi fizik, i cili e kryen punën për pagë nën drejtimin dhe kontrollin e punëdhënësit, pavarësisht se a kryhet puna sipas kontratës ose ndonjë forme tjetër të marrëveshjes, qoftë e bërë me shkrim apo jo.</p> <p>1.7. Punëdhënës – çdo person afarist apo entitet që paguan paga, përfshirë edhe:</p> <p>1.7.1. Autoritetin Publik;</p> <p>1.7.2. Njësinë e përhershme të personit jo-rezident;</p> <p>1.7.3. Organizatën jo qeveritare;</p> <p>1.7.4. Organizatën ndërkombëtare,</p>	<p>entity with special rights, obligations, responsibilities and authorizations for implementation of the Law on Health Insurance on behalf of the insured persons, including effective collection of financial means for provision of health care services by health care institutions in all types of ownership;</p> <p>1.4. The insured - a person who can prove of being covered by health insurance;</p> <p>1.5. Close family members – are considered: spouse, parents, children up to the age of eighteen (18), including adopted children, stepchild, stepparent;</p> <p>1.6. Employee – a natural person who performs paid work under the direction and control of the employer, whether the work is performed under the contract or any other form of agreement, whether in writing or not.</p> <p>1.7. Employer - any natural person or legal entity that pays salaries, including:</p> <p>1.7.1. Public Authority;</p> <p>1.7.2. Permanent unit of a non-resident person;</p> <p>1.7.3. Non-governmental organization;</p>	<p>obavezama, odgovornostima i posebnim ovlašćenjima za sprovođenje Zakona o zdravstvenom osiguranju u ime osiguranika obuhvatajući efikasno prikupljanje finansijskih sredstava u cilju pružanja usluga zdravstvene zaštite zdravstvenih institucija u svim oblicima svojine;</p> <p>1.4. Osiguranik - lice koje dokaže da je zdravstveno osigurano;</p> <p>1.5. Članom uže porodice - smatraju se: suprug/a, roditelji, deca do 18 (osamnaest) godina starosti, uključujući usvojenu decu, očuha i maćehu;</p> <p>1.6. Zaposleni - fizičko lice koje obavlja posao za platu pod upravom i kontrolom poslodavca, bez obzira da li posao obavlja prema ugovoru ili bilo kojim drugim oblikom sporazuma, bilo u pisanoj formi ili ne.</p> <p>1.7. Poslodavac – svako poslovno lice ili subjekat koji isplaćuje plate, uključujući i:</p> <p>1.7.1. Javni organ;</p> <p>1.7.2. Stalnu jedinicu nerezidenta;</p> <p>1.7.3. Nevladinu organizaciju;</p> <p>1.7.4. Međunarodnu organizaciju,</p>
--	--	---

<p>duke përfshirë KFOR-in dhe EULEX-in, me përjashtim të Kombeve të Bashkuara, Agjencitë e Specializuara të saj dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Atomike.</p> <p>1.7.5. Përfaqësitë diplomatike, konsullore dhe zyrat ndërlidhëse të shteteve të huaja në Kosovë kur ato pajtohen që të marrin përsipër përgjegjësitë e një punëdhënësi në Kosovë; dhe</p> <p>1.7.6. Bashkësitë fetare – të parapara me Ligjin për Lirinë Fetare në Kosovë.</p> <p>1.8. Pagesa e premiumit - shuma mujore, tre (3) mujore ose vjetore për sigurim shëndetësor që paguhet në Fond;</p> <p>1.9. Agjencioni i Financimit Shëndetësor - Agjencioni ekzekutiv nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë, paraardhës i Fondit publik të Kosovës për sigurime shëndetësore, që në emër të shtetit realizon të drejtat, obligimet, përgjegjësitë, dhe autorizimet përkitazi me kontraktimin dhe blerjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë, si edhe grumbullimin e të gjitha mjeteve</p>	<p>1.7.4. International organization, including KFOR and EULEX, with the exception of the United Nations, its Specialized Agencies and the International Atomic Energy Agency.</p> <p>1.7.5. Diplomatic, consular and liaison offices of foreign states in Kosovo when they agree to take on the responsibilities of an employer in Kosovo; and</p> <p>1.7.6. Religious communities - set out by the Law on Religious Freedom in Kosovo.</p> <p>1.8. Premium Contributions - the monthly, quarterly or annual health insurance amount to be paid to the Fund;</p> <p>1.9. Health Financing Agency - is the executive Agency under the authority of the Ministry of Health, predecessor of the Kosovo public Health Insurance Fund, that on behalf of the state realizes the rights, obligations, responsibilities, and authorizations regarding contracting, and buying healthcare services from healthcare institutions in all forms of ownership, as well as pooling all financial means of the Fund for this purpose, until the</p>	<p>uključujući KFOR i EULEX, sa izuzetkom Ujedinjenih nacija, njene Specijalizovane agencije i Međunarodnu agenciju za atomsku energiju.</p> <p>1.7.5. Diplomatska i konzularna predstavništva, kancelarije za vezu stranih država na Kosovu, kada su saglasne da preuzmu odgovornost poslodavca na Kosovu; i</p> <p>1.7.6. Verske zajednice - predviđene Zakonom o verskim slobodama na Kosovu</p> <p>1.8. Uplata premije - mesečni, tromesečni (3), ili godišnji iznos zdravstvenog osiguranja koji se uplaćuje u Fond;</p> <p>1.9. Agencija zdravstvenog finansiranja - izvršna agencija pod nadležnošću Ministarstva zdravlja, prethodnica Javnog fonda Kosova za zdravstveno osiguranje, koja u ime države realizuje prava, obaveze, odgovornosti i ovlašćenja u vezi ugovaranja i kupovine usluga zdravstvene zaštite od strane zdravstvenih institucija u svim oblicima vlasništva, kao i sakupljanje svih finansijskih sredstava fonda za tu namenu, do osnivanja fonda na osnovu</p>
---	--	---

<p>financiare të Fondit për këtë qëllim, deri në themelimin e Fondit me Ligjin e Sigurimit Shëndetësor;</p> <p>1.10. Periudha e pritjes - periudha gjatë të cilës qytetari ose banori nuk arrin të paguaj premiumin e sigurimit shëndetësor gjatë tre (3) muajve radhazi.</p> <p>2. Përkufizimet e përdorura në këtë paragraf, të përcaktuara nga ligjet përkatëse, do të vlejnjë edhe në këtë Udhëzim Administrativ:</p> <p>2.1 Paga – kompensimi financiar ose llojet e tjera të kompensimit, duke i përfshirë mallrat, bonuset, favoret, shërbimet ose shkëmbimet që paguhen në lidhje me punësimin në Kosovë.</p> <p>2.2 Të ardhurat bruto nga pagat – ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Tatimin në Të Ardhurat Personale.</p> <p>2.3 Aktivitet ekonomik- ashtu siç është përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, nënkupton çdo aktivitet të prodhuesve, tregtarëve ose personave që furnizojnë mallra dhe shërbime, duke përfshirë aktivitetet e minierave dhe ato bujqësore, si dhe aktivitetet e</p>	<p>establishment of Fund by the Law on Health Insurance;</p> <p>1.10. Grace period – period when citizen or resident does not pay the premium health insurance for three (3) consecutive months.</p> <p>2. Definitions used in this paragraph, as defined by relevant laws, will also apply to this Administrative Instruction:</p> <p>2.1 Wages – means financial and other kinds of compensation, including goods, favours, services, or barter, paid in connection with employment in Kosovo.</p> <p>2.2 Gross income from wages - as defined by the Law on Personal Income Tax.</p> <p>2.3 Economic activity - as stipulated in Law No. 03/L-222 on Tax Administration and Procedures, means any activity of producers, traders or persons supplying goods or services including mining and agricultural activities and activities of the</p>	<p>Zakona o zdravstvenom osiguranju;</p> <p>1.10. Period čekanja - period kada građani ili stanovnici ne plate zdravstveno osiguranje tri (3) meseca za redom.</p> <p>2. Izrazi koji se koriste u ovom stavu, određeni relevantnim zakonima, važiće i u ovom Administrativnom uputstvu:</p> <p>2.1 Plata - finansijska naknada ili druge vrste naknade, uključujući robu, bonuse, usluge, usluge ili razmene, isplaćene u vezi sa zaposlenjem na Kosovu.</p> <p>2.2 Bruto prihodi iz plata – kao što je predviđeno Zakonom o porezu na lični dohodak.</p> <p>2.3 Ekonomska delatnost - kao što je predviđeno Zakonom br. 03/L-222 o poreskoj administraciji i postupcima, podrazumeva svaku aktivnost proizvođača, trgovaca ili davalaca roba i usluge, uključujući rudarske i poljoprivredne aktivnosti, kao i aktivnosti profesija. Eksploatacija na</p>
---	---	--

<p>profesioneve. Eksploatimi në baza të vazhdueshme i pasurive të prekshme ose të pa prekshme me qëllim të sigurimit të të ardhurave në veçanti duhet të konsiderohet si një aktivitet ekonomik;</p> <p>2.4 TVSH – Tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas ligjit të TVSH-së në Kosovë.</p> <p>2.5 Identifikimi i statusit të të siguarit - nënkupton numrin personal në Letërnjoftimin e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, deri në lëshimin e Kartelës Individuale të Sigurimit Shëndetësor;</p> <p>2.6 Person i vetëpunësuar - ashtu siç është përcaktuar në ne Ligjin mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, nënkupton çdo person fizik i cili punon për përfitim personal, në para të holla apo natyrë, i cili nuk përfshihet me përkufizimin e një punonjësi sipas këtij ligji. Një person i vetëpunësuar përfshin ndërmarrje personale biznesi dhe ortak të angazhuar në aktivitet ekonomik.</p> <p>2.7 ATK - nënkupton Administratën Tatimore të Kosovës.</p> <p>2.8 UNIREF-nënkupton Nënkupton numrin specifik të deklaratës dhe fletëpagesës.</p>	<p>professions. The exploitation of tangible or intangible property for the purposes of obtaining income there from on a continuing basis shall in particular be regarded as an economic activity;</p> <p>2.4 VAT - Value Added Tax according to Law on VAT in Kosovo.</p> <p>2.5 Identification of the insured status - means personal number from Identity Card issued by the Ministry of Internal Affairs of the Republic of Kosovo, to the issuance of Individual Health Insurance Card;</p> <p>2.6 Self-employed person – as stipulated in the Law on Tax Administration and Procedures, means any natural person who works for personal gain, in cash or in kind, who is not covered by the definition of an employee under this law. A self-employed person includes a personal business enterprise and a partner engaged in a business activity.</p> <p>2.7 TAK - means the Tax Administration of Kosovo.</p> <p>2.8 UNIREF - means a specific number of declaration and payment slip.</p>	<p>trajnoj osnovi materijalna ili nematerijalna radi dobijanja prihoda posebno se smatrati ekonomske aktivnosti;</p> <p>2.4 PDV - porez na dodatu vrednost u skladu sa Zakonom o PDV- u na Kosovu.</p> <p>2.5 Identifikacija statusa osiguranika - podrazumeva lični broj u ličnoj karti izdata od strane Ministarstva unutrašnjih poslova Republike Kosova, do izdavanja pojedinačnih kartica zdravstvenog osiguranja;</p> <p>2.6 Samozaposleno lice - kako je propisano u Zakonu o poreskoj administraciji i postupcima, podrazumeva svako fizičko lice koje radi za ličnu dobit, u novcu ili u naturi, koji nije obuhvaćen definicijom zaposlenog u skladu sa ovim zakonom. Samozaposleno lice uključuje lično poslovno preduzeće i partnera koji učestvuje u privrednoj aktivnosti.</p> <p>2.7 PAK – označava Poresku administraciju Kosova.</p> <p>2.8 UNIREF- označava specifični broj deklaracije i uplatnice.</p>
---	---	--

<p>2.9 BQK-nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Përkufizimet e përdorura në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, do të vlejnjë edhe në Udhëzim Administrativ për mbledhjen e premiumeve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Mbledhja e Premiumeve</p> <p>Premiumet do të mblidhen nëpërmjet Administratës Tatimore të Kosovës dhe bankave komerciale për llogari të Agjencionit për Financimin Shëndetësor, deri në themelimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore, në përputhje me dispozitat e Ligjit për sigurimin shëndetësor dhe të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Personat e Siguruar në Mënyrë të Obligueshme</p> <p>1. Personat e siguruar në mënyrë të obligueshme janë të gjithë personat, si vijon:</p> <p>1.1. Të gjithë qytetarët dhe banorët, të cilët kanë bërë pagesën e premiumit për sigurimin shëndetësor të obligueshëm;</p> <p>1.2. Anëtarët e familjes së ngushtë të</p>	<p>2.9 CBK - means the Central Bank of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Terms used in Article 3 of Law no. 04 / L-249 on Health Insurance, shall also apply to the Administrative Instruction on collection of premiums for mandatory health insurance.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Collection of Premiums</p> <p>Premiums will be collected through Tax Administration of Kosova and commercial banks on behalf of the Health Financing Agency, until the establishment of the Health Insurance Fund, in accordance with the Law on Health Insurance and this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Mandatory Insured Persons</p> <p>1. The persons insured in a mandatory way are all personas as follows:</p> <p>1.1. All citizens and residents, who have paid mandatory health insurance;</p> <p>1.2. Close family members of citizens and</p>	<p>2.9 BQK-označava Centralnu Banku Republike Kosovo.</p> <p>3. Izrazi upotrebljeni u članu 3 Zakona br . 04 / L - 249 za zdravstveno osiguranje, vaze i u Administrativnom Uputstvu za sakupljanje premije za obavezno zdravstveno osiguranje.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Sakupljanje premija</p> <p>Premije će se sakupljati preko Poreske Administracije Kosova i komercijalnih banaka za račun Agencije za Zdravstveno Finansiranje, do osnivanja Fonda za zdravstveno osiguranje u skladu sa odredbama Zakona o zdravstvenom osiguranju i ovog Administrativnog uputstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Obavezni osiguranici</p> <p>1. Obavezni osiguranici su sva sledeća lica:</p> <p>1.1. svi građani i stanovnici, koji su platili premije za obavezno zdravstveno osiguranje;</p> <p>1.2. članovi uže porodice građana ili stanovnika koji su uplatili premije</p>
---	---	--

<p>qytetarëve ose banorëve të cilët kanë paguar premiumet e sigurimit të obligueshëm shëndetësor dhe të cilët janë të punësuar në sektorin publik, privat ose publiko-private në kompanitë e regjistruara për TVSH;</p> <p>1.3. Qytetarët ose banorët të cilët janë të liruar nga obligimi për të paguar këtë premium, në pajtim me Ligjin për Sigurimin Shëndetësor.</p>	<p>residents who have paid mandatory health insurance premiums and are public sector employees or employed in private or public-private VAT-registered companies;</p> <p>1.3. Citizens and residents who are exempt from the obligation to pay this premium in accordance with the Law on Health Insurance.</p>	<p>obaveznog zdravstvenog osiguranja i koji su zaposleni u javnom, privatnom ili javno-privatnom sektoru u kompanijama koje su registrovane za PDV;</p> <p>1.3. građani ili stanovnici koji su oslobođeni od obaveze da uplate ovu premiju u skladu sa Zakonom o zdravstvenom osiguranju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Financimi i Sigurimit Shëndetësor të Obligueshëm</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Financing Mandatory Health Insurance</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Finansiranje obaveznog zdravstvenog osiguranja</p>
<p>1. Premiumet për sigurimin shëndetësor të obligueshëm do t'i paguhen Fondit si :</p> <p>1.1. Premiume për sigurimin shëndetësor të obligueshëm bazuar në të ardhurat personale dhe kompensimet e të punësuarve në sektorin publik, të ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet të punësuarve dhe punëdhënësve;</p> <p>1.2. Premiume për sigurimin shëndetësor të obligueshëm bazuar në të ardhurat personale dhe kompensimet e të punësuarve në sektorin privat dhe publiko-privat në ndërmarrjet e regjistruara për TVSH, të ndara në mënyrë të barabartë ndërmjet të</p>	<p>1. Mandatory health insurance premiums are paid to the Fund as:</p> <p>1.1. Mandatory health insurance premiums based on the personal incomes and compensation of public sector employees, shared equally by employees and employers;</p> <p>1.2. Mandatory health insurance premiums based on the personal incomes and compensation of private and public-private sector employees in VAT registered enterprises, shared equally by employees and employers;</p>	<p>1. Premije za obavezno zdravstveno osiguranje će se plaćati Fondu kao:</p> <p>1.1. Premije za obavezno zdravstveno osiguranje na osnovu ličnih dohodaka i naknada zaposlenih u javnom sektoru podeljena na jednake delove između zaposlenih i poslodavaca;</p> <p>1.2. Premije za obavezno zdravstveno osiguranje na osnovu ličnih dohodaka i naknada zaposlenih u privatnom i javno-privatnom sektoru u preduzećima registriranim za PDV, jednako podeljene između zaposlenih i poslodavaca;</p>

<p>punësuarve dhe punëdhënësve;</p> <p>1.3. Premiume për sigurim shëndetësor të obligueshëm nga të gjithë qytetarët dhe banorët e tjerë, përveç anëtarëve të familjes së ngushtë të qytetarëve dhe banorëve nga nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2;</p> <p>1.4. Transfere financiare nga Buxheti i Kosovës në Fond në emër të pagesës së premiumeve të sigurimit shëndetësor për personat nga neni 11 paragrafi 2. i Ligjit për Sigurimin Shëndetësor; për shërbimet e rregullta të kujdesit shëndetësor themelor në nivelin dytësor dhe tretësor; si dhe për shërbimet esenciale të kujdesit shëndetësor nga neni 7 i Ligjit për Sigurimin Shëndetësor, në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor; sipas buxhetit vjetor për sektorin e shëndetësisë në pajtim me kornizën afat-mesme të shpenzimeve;</p> <p>1.5. Pagesa nga shtetet e tjera, sipas marrëveshjeve ndërshtetërore dhe fondet e sigurimeve shëndetësore të shteteve të tjera në bazë të marrëveshjeve bilaterale;</p> <p>1.6. Donacione dhe burime të tjera;</p>	<p>1.3. Mandatory health insurance premiums from all other citizens and residents, except close family members of citizens and residents in sub-paragraph 1.1 and 1.2;</p> <p>1.4. Budget transfers from the Kosovo budget to the Fund dedicated to payment of the mandatory health insurance premiums for persons from Article 11 paragraph 2. of the Law on Health Insurance; for regular health care services at secondary and tertiary level; and essential healthcare services from Article 7 of the Law on Health Insurance, at all levels of the health care, as foreseen in the annual budget for the health sector according to the midterm expenditure framework;</p> <p>1.5. Payments from other countries in compliance with inter-country agreements and health insurance funds of other countries, based on bilateral agreements;</p> <p>1.6. Donations and other sources;</p>	<p>1.3. Premije za obavezno zdravstveno osiguranje od strane svih ostalih građana i stanovnika, osim članova uže porodice građana i stanovnika iz pod-stava 1.1. i 1.2;</p> <p>1.4. Finansijski transferi iz budžeta Kosova u Fond sa ciljem uplate premija obaveznog zdravstvenog osiguranja za lica iz člana 11. stav 2. Zakona o zdravstvenom osiguranju; za redovne usluge osnovne zdravstvene zaštite na sekundarnom i tercijarnom nivou; kao i za osnovne usluge zdravstvene zaštite iz člana 7. Zakona o zdravstvenom osiguranju na svim nivoima zdravstvene zaštite, prema godišnjem budžetom za sektor zdravstva u skladu sa srednjoročnim okvirom troškova;</p> <p>1.5. Uplate iz drugih država prema međudržavnim sporazumima i fondovima zdravstvenog osiguranja drugih zemalja u skladu sa bilateralnim sporazumom;</p> <p>1.6. Donacije i drugi izvori;</p> <p>1.7. Prihodi iz fonda rezervi.</p>
--	--	---

<p>1.7. Fitime nga Fondi Rezervë.</p> <p>2. Nëse dy ose më shumë anëtarë të familjes janë të punësuar në institucionet nga nënparagrafi 1.1. dhe 1.2, të gjithë të punësuarit janë të obliguar që të bëjnë pagesën e premiumit të obligueshëm të sigurimit shëndetësor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Afati Kohor për Pagesën dhe Mbledhjen e Premieeve</p> <p>1. Mbledhja e premieeve do të bëhet pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 37, paragrafi 10, nënparagrafi 10.1-10.6 të Ligjit për Sigurimin Shëndetësor.</p> <p>2. Mënyra dhe monitorimi i pagesës së premieeve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm do të bëhet në përputhje me nenin 23 paragrafi 1, 2, 3 4 dhe 5 të Ligjit për Sigurimin Shëndetësor.</p> <p>3. Mbledhja e premieeve do të bëhet sipas procedurave të Administratës Tatimore të Kosovës, në bazë të Marrëveshjes dypalëshe, akteve juridike në fuqi dhe këtij UA.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Obligimet e Personave Përgjegjës për Pagesën e Premieeve</p>	<p>1.7. Earnings from the Reserve Fund.</p> <p>2. If two or more family members are employed in institutions from sub-paragraph 1.1 and 1.2, all employees are obligated to pay the mandatory health insurance premium.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Timeframe for Payment and Collection of Premiums</p> <p>1. Collection of premiums will be made upon meeting the conditions set out in Article 37, paragraph 10, subparagraph 10.1 to 10.6 of the Law on Health Insurance.</p> <p>2. The method and monitoring of the payment of premiums for mandatory health insurance will be made in accordance with Article 23, paragraph 1, 2, 3, 4 and 5 of the Law on Health Insurance.</p> <p>3. Collection of premiums will be based on the procedures of the Tax Administration of Kosovo, based on the bilateral agreement, the legal acts in force and this AI.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Obligations of Persons Responsible for Premium Payments</p>	<p>2. Ukoliko su jedan ili više članova porodice zaposleni u institucijama iz pod-stava 1.1. i 1.2., svi zaposleni su obavezni da izvrše uplatu premije obaveznog zdravstvenog osiguranja.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Rok za uplatu i sakupljanje premija</p> <p>1. Sakupljanje premija će se izvršiti nakon ispunjenja uslova iz člana 37. stav 10 , tačka 10.1 - 10.6 Zakona o zdravstvenom osiguranju.</p> <p>2. Način i nadzor uplate premija za obavezno zdravstveno osiguranje će se vršiti u skladu sa članom 23. stav 1, 2, 3, 4 i 5 Zakona o zdravstvenom osiguranju.</p> <p>3. Sakupljanje premija će se izvršiti u skladu sa postupcima Poreske administracije Kosova, na osnovu bilateralnog sporazuma, pravnih akata koji su na snazi i ovog AU.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Obaveze odgovornih lica za plaćanje premija</p> <p>1. Fizičko lice je obavezno da plati premije za</p>
--	---	---

<p>1. Personi fizik obligohet për të paguar premiumet për sigurimin shëndetësor të detyrueshëm në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve të muajit vijues, dhe në shumën e përcaktuar me LSSH, Neni 37.2; përmes bankave komerciale, në xhirollogarinë e AFSH/Fondit.</p> <p>2. Punëdhënësi në sektorin privat është përgjegjës për pagesën e pjesës së premiumit së punëtorëve dhe punëdhënësit me listën e pagave, përmes bankave komerciale, në xhirollogarinë e AFSH/Fondit.</p> <p>3. Punëdhënësi në sektorin publik është përgjegjës për pagesën e pjesës së premiumit së punëtorëve dhe punëdhënësit me listën e pagave, përmes Thesarit të Shtetit, në xhirollogarinë e AFSH/Fondit.</p> <p>4. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e premiumit përmes bankave komerciale, në xhirollogarinë e AFSH/Fondit.</p>	<p>1. A natural person is obliged to pay premiums for mandatory health insurance within fifteen (15) days of the following month, and in an amount determined by LHI, Article 37.2; through commercial banks, on account of the HFA/Fund.</p> <p>2. The private sector employer is responsible for paying part of the premium for the workers and employer with payroll, through commercial banks, in the account of the HFA/Fund.</p> <p>3. The public sector employer is responsible for paying part of the premium for the workers and employer with payroll, through the State Treasury, on account of HFA/Fund.</p> <p>4. Self-employed person is responsible for payment of premium through commercial banks, on account of the HFA/Fund.</p>	<p>obavezno zdravstveno osiguranje na vreme, u roku od petnaest (15) dana narednog mjeseca, i u visini utvrđenoj prema ZZO, član 37.2; preko komercijalnih banaka, na žiro račun AFZ/Fonda.</p> <p>2. Poslodavac u privatnom sektoru je odgovoran za plaćanje dela premije za zaposlene i poslodavce sa platnog spiska, preko komercijalnih banaka, na žiro račun AFZ/Fonda.</p> <p>3. Poslodavac u javnom sektoru je odgovoran za plaćanje dela premije za zaposlene i poslodavce sa platnog spiska, preko državnog trezora, na žiro račun AFZ/Fonda.</p> <p>4. Samozaposleno lice je odgovorno za plaćanje premije preko komercijalnih banaka, na žiro račun AFZ/Fonda.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Përqindjet dhe Nivelet e Premieeve</p> <p>1. Përqindjet dhe nivelet e premieeve për</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Percentages and Levels of Premiums</p> <p>1. Percentages and levels of premiums for</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Procenti i nivoi premija</p> <p>1. Procenti i nivoi premija za obavezno zdravstveno osiguranje će se obračunavati</p>

